

# Shënime mbi plotësimin e FORMULARIT TË KËRKESËS JO-PRONËSORE NË PROCEDURË TË LIKUIDIMIT

## 1.HYRJE

Shënimet në vijim jepen për të ndihmuar pretenduesit në plotësimin e Formularit të Kërkesës Jo-Pronësore (L25a Dëshmia e Kërkesës) në Likuidim. Nëse jeni në dyshim lidhur me ndonjë aspekt të kërkesës suaj, ne ju këshillojmë të kërkonti këshillë dhe ndihmë juridike të pavarur. Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk mund të ofrojë ndihmë të tillë.

Vëmendje të posaçme duhet ti kushtohet detyrimit për nënshkrimin e Formularit të Kërkesës. Faksat dhe kopjet janë të pranueshme, por Autoriteti i Likuidimit rezervon të drejtën të kërkojë origjinalin në çdo kohë.

Keni kujdes të **mos përdorni** këtë formular për kërkesa lidhur me përfshirjen në listat e punëtorëve për pjesëmarrje në 20% të të ardhurave që rrjedhin nga Privatizimi apo Likuidimi i Ndërmarrjes Shoqërore. Nëse paraqisni një kërkesë të tillë nëpërmjet këtij formulari ajo nuk do të shqyrtohet.

Vëreni në krah të majtë janë shënuar referencat përkatëse ligjore për llojin respektiv të kërkesës (Neni 40.1.4, Neni 40.1.6.2, Neni 40.1.7 i Shtojcës së Ligjit mbi AKP-në).

### 1.1 EMRI I NDËRMARRJES SHOQËRORE

Emri i Ndërmarrjes Shoqërore është i domosdoshme të ceket pasi vetëm në këtë mënyrë mund të identifikohet dhe të ndahet kërkesa juaj për të bërë më pas të mundur shqyrtimin e saj prej Autoritetit të Likuidimit kompetent.

### 1.2 EMRI DHE ADRESA E PRETENDUESIT

PARASHTRUESI i KËRKESËS është person fizik apo juridik i cili ka pretendim ndaj ndërmarrjes shoqërore.

Nëse jeni person fizik ju lutemi shkruani në kuadrin përkatës emrin e plotë, adresën postare dhe numrin kontaktues të telefonit fiks dhe mobil, nëse kjo është e mundur.

Nëse jeni person juridik ju lutemi shkruani emrin e regjistruar (dhe çfarëdo emri tjetër alternativë), adresat postare të regjistruara, numrin e telefonit dhe emrin e personit kontaktues.

## 2. KËRKESAT E SIGURUARA DHE PENGJET, HIPOTEKAT APO KOLATERALET E TJERA

Plotësoni duke shënuar në katrorin përkatës nëse kërkesa juaj është një kërkesë e siguruar me një prej mënyrave për sigurimin e kërkesës (pengu hipoteka, barra etj). Cekni mjetin e sigurimit dhe listoni në katrorin përkatës asetin.

Deklaroni dhe dëshmoni se si/ku është regjistruar dhe datat e regjistrimit.

Ju lutem siguroni (në letër shtesë) detaje të mjaftueshme të aseteve mbi të cilat pretendohet pengu/hipoteka (kontratën valide, vendndodhjen fizike, etj) në mënyrë që të mund të identifikohen

fizikisht. Nëse është e mundur, paraqitni gjithashtu një vlerësim të vlerave individuale të secilës pasuri (aset).

Bashkangjisni kopjet e kontratave të dhëna nga ndërmarrja që dëshmon hipotekën apo kolateralin dhe gjithashtu identifikoni asetet e dhëna si siguri për shumën e kërkuar.

Konfirmoni shumën e kërkesës që është e siguruar nga kjo hipotekë/ kolateral.

## **2.1 LLOJI DHE SHUMA E KËRKESËS**

Zgjedhni llojin që i përgjigjet më së miri KËRKESËS dhe shkruani shumën e plotë përkrah. Nëse shumën e plotë është e përbërë nga më shumë se një njësi (p.sh disa fatura për mallra), bashkangjitni një listë të ndarë e cila i identifikon njësitë e veçanta, vlerat e tyre dhe shumën e plotë, njëjtë siç është dhënë në formular. Nëse nuk është e mundur në të gjitha rastet të jepet vlera e saktë, atëherë shkruani një vlerë të përafërt dhe përshkruani atë si vlerësim të përafërt.

## **3. KËRKESAT NGA MARRËDHËNIA E PUNËS**

Të drejtat e punëtorëve të NSH-ve në likuidimi meritojnë një elaborim shtesë:

3.1 Ish-punëtorët e ndërmarrjes shoqërore në likuidim kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesat e pasiguruara por prioritare për **kompesim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës**, si rezultat i një veprimi të ndërmarrë nga Agjensia Kosovare e Privatizimit, paraardhësja e saj apo Autoriteti i Likuidimit, si për shembull vendimi për privatizimin ose likuidimin e NSH-së (Neni 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në).

3.2 Ish-punëtorët mund të paraqesin kërkesë për pagimin e pagave të papaguara nga Ndërmarrja Shoqërore. Kërkesa duhet të përmbajë përveç vlerës monetare edhe numrin e pagave të papaguara. Vlera monetare e tre pagave të papaguara do të kategorizohet si pagesë prioritare për efekt të shkallës së prioritetit të pagesës sipas nenit 40.1.6.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Vlera e mbetur në rastet kur kërkesa e miratuar përmban më tepër se tre paga të papaguara do të klasifikohet si pagesë e kërkesës së pasiguar dhe jo-prioritare sipas nenit 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në.

## **4. KËRKESAT E PASIGURUARA**

Çfarëdo kërkesë tjetër e pasiguar në likuidim mund të paraqitet duke plotësuar katrorin përkatës të llojit të kërkesës si psh. “Furnizuesit e brendshëm” apo “Rryma” për kërkesat e KEK-ut. Pretenduesi duhet të sigurohet që përkrah llojit të kërkesës të shënojë vlerën e saj. Në rast se kërkesa juaj nuk mund të kategorizohet në asnjërin prej llojeve të renditura përkrah katrorëve përkatës, shënoni katrorin e fundit “kërkesa të tjera”, mirëpo ju lutemi çartësoni në formularë apo në një letër shtesë detajet e kërkesës së tillë ndaj ndërmarrjes.

## **5. DOKUMENTET MBËSHTETËSE**

Shkruani këtu një përmbledhje të dokumenteve që do ti bashkangjiten formularit në mbështetje të kërkesës tuaj. Nëse hapësira në formular për të paraqitur të gjitha dokumentet e bashkangjitura është e pamjaftueshme ju lutem përdorni një letër shtesë.

Vëni re se: Mos parashtrimi/bashkëngjitja e dokumentacionit mbështetës kërkesës tuaj, kërkesa juaj do të konsiderohet si e papranueshme dhe rrjedhimisht nuk do të shqyrtohet/vlerësohet nga ana e

Autoritetit të Likuidimit, gjë e cila vlen edhe për kërkesat e pakompletuara të cilat parashtrohen /dërgohen përmes postës.

**MOS BASHKANGJITNI DOKUMENTE ORIGJINALE** – vetëm kopjet të cilat i keni të vërtetuara nga origjinali te shërbimi i noterisë – Noteri.

## **6. DEKLARATË MBI VERTETËSINË**

Ju lutemi siguroni që kjo deklaratë të plotësohet. Shkruani emrin e pretenduesit (personi fizik apo juridik). Nëse kërkesa paraqitet nga një person i autorizuar në emër të pretenduesit, personi i autorizuar duhet gjithashtu të nënshkruajë. Autorizimi i vërtetuar ligjërisht duhet të bashkangjitet formularit. Në fund, nënshkrimet duhet të jenë origjinale të shkruara me dorë.

**Autoriteti i Likuidimit rezervon të drejtën që kërkesat e panënshkruara apo të paplotësuara në mënyrë të rregullt të mos i marrë në konsideratë.**

**Vërejtje: Cilido person që me vetëdije paraqet kërkesë e cila është falso do të ndiqet penalisht.**